



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KRUJË

Nr 8419 Prot

Krujë më 10 / 12 / 2020

V E N D I M
Nr 256 date 10.12.2020

**“ PËR MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË PLANIT TË DETYRUAR VENDOR PËR
ZONËN E RE PËR ZHVILLIM ZONA 1, NJËSIA ADMINISTRATIVE FUSHË
KRUJË, BASHKIA KRUJË ”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, pika 9, pika 1/1, shkronja “b” dhe nenit 23, pika 14 e Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Ligjit Nr.97/2019 “Për miratimin e Aktit Normativ Nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar, të Vendimit Nr.887, datë 24.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e Planit të Detyruar Vendor, si dhe procedurës së miratimit të Lejeve të Zhvillimit/Ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, i ndryshuar, të Vendimit Nr.63, datë 29.01.2020 “Për shpalljen e Zonës së Re për Zhvillim në Njësinë Administrative Fushe Kruje, Bashkia Krujë, si dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese”, të Vendimit Nr.686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar,

VENDOSA:

1. Miratimin e Rishikimit të Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim, Zona 1, Njësia Administrative Fushe Kruje, Bashkia Krujë, në funksion të procesit të rindërtimit, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në aktet normative në fuqi, pjesë e të cilit janë dokumentat e mëposhtme:
 - a) Dokumenti i Rishikimit të Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re për Zhvillim, Zona 1, Njësia Administrative Fushe Kruje, Bashkia Krujë;

b) Materiali Hartografik.

2. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për botimin e Vendimit dhe dokumentat shoqërues të tij, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e miratimit të tij.
3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi pas botimit në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

